



Kryetari i Komunës 01-nr.465- 32892, Dt.10.06.2021 - S u h a r e k ë

Në bazë të nenit 4 pika 2, 2.4 dhe 3.3, neni 8 pika 5, të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme Nr.03/L-139 me ndryshim dhe plotësime e bëra me Ligjin Nr-03/L-205, dhe nenit 44 të LPPA-së nr-05/ L.031, dhe kërkesës së subjektit kërkues-Drejtorisë për Shërbime Publike të Komunës së Suharekës nr.01-104-32798, datë 10.06.2021 për shpronësimin e pronës së paluajtshme për interes publik dhe për ndërtimin e rrugës publike në ZK.Sopijë, Kryetari i Komunës së Suharekës, merrë këtë :

V E N D I M

1. Aprovohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës së subjektit kërkues-Drejtorisë për shërbime Publike të Komunës së Suharekës, për shpronësimin e pronës së paluajtshme, pronë private e pronarve dhe zotuesve të interesit, për interes publik dhe për ndërtimin dhe zgjerimin e rrugës publike e cila gjendet në pjesën e ngastrës kadastrale me nr. P-72116043-00862-0, në sip. prej: 55 m², në vendin e quajtur "Drum-Shirokë e evidentuara sipas qartifikatës së pronë emër të Hamdi (Fejz) Berishaj, ZK. Sopië.

2. Vlera e kompenzimit të pronës së cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, caktohet nga Ministria e Financave-Zyra e veçantë për vlersimin e pronës së paluajtshme, konform Ligjit për Shpronësimin e pronës së paluajtshme Nr.03/L-139 me ndryshim dhe plotësime e bëra me Ligjin Nr-03/L-205 për zbatimin e metodeve dhe kritereve teknike të vlersimit që do të përdoren për përlogaritjen e shumës së kompenzimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin.

3. Për zbatimin e këtij Vendimi, obligohet Departamenti për shpronësim në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër .

4. Ky Vendim hynë në fuqi ditën e publikimit në Gazetën zyrtare të Kosovës dhe në një gazetë me tirazh më të madh në Rep. Kosovës.

Iu dërgohet:

Subjektit kërkues;

Pronarit dhe zotëruesit të interesit,

Arkivit.

Kryetari i Komunës
Bali Muharremaj

